



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 35 datë 26.10.2023

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË
NGURTA URBANE (MNU) BASHKIA SHKODËR ”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 36.10.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.8419, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Nenin 54, shkronja “k” të ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”; Ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, të ndryshuar ; Ligjin Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar; Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar; Ligjin nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”; Ligjin Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”; Ligjin Nr.89/2022 “Për policinë Bashkiake”; VKM Nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake”; VKM Nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”;VKM Nr.660, datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”;VKM Nr.608, datë 17.9.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”; VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", të ndryshuar; VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura; VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; VKM nr.117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje", të ndryshuar VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për

bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre";VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura";VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"; VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për lëndfill-et e mbetjeve", të ndryshuar ;VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", të ndryshuar ;VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"; VKM Nr.319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"; VKM nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035", VKM Nr.447, datë 16.06.2010 "Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"; VKM Nr.652 datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura;Urdher nr.994 datë 30.08.2023 "Mbi miratimin dhe zbatimin e PSV për administrimin e Ofrimit të Shërbimit të Pastrimit për Bashkinë Shkodër" si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për Miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Urbane (Mnu) Bashkia Shkodër" sipas materialit bashkëngjitur, pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Kjo rregullore zbatohet me ndryshimin e paketës fiskale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULI

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 45 vota

Vota Pro 45

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 31.10.2023